



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Prrenjas, më _____. _____. 2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale elektrike për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit të rrugëve dhe institucioneve arsimore në varësi të bashkisë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Materiale elektrike: 31681410–0

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,708,220 (një milion e shtatëqind e tetë mijë e dyqind e njëzet)Lekë, pa TVSH.

Vlera limit e kontratës është përcaktuar në zbatim të nenit 76, pika “1”, gërma “b” e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Prrenjas ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

➤ Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, pika 1 e Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim xhiroje vjetore të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (përkatësisht vitet 2022, 2023 dhe 2024), ku vlera e xhiros vjetore për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur edhe në qoftë se operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar më lart nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, si dhe nenin 43, pika 2, gërma c (***në rastin e procedurës së hapur të thjeshtuar neni 55, pika 4***) të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" etj.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti/Enti Kontraktor në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si më poshtë vijon:

2.3.1 Dëshmi për furnizime të ngjashme të mëparshme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, për të cilën konkuron operatori ekonomik, që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si më poshtë:

- a.** Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një Ent publik, kontrata furnizimi dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore. **(ose)**
 - b.** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.
-

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Regullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë.

Për këtë subjekti ofertues duhet të paraqesi certifikatën e mëposhtme:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose Ekuivalenten e saj (të vlefshme), lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standarteve ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Certifikata për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 është e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të vërtetuar dhe të garantoj realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues, nëse nuk është prodhues për artikujt e kërkuar duhet të paraqesi Autorizim/Kontratë furnizimi nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar i cili merr përsipër të furnizojë ofertuesin me artikujt objekt prokurimi. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet dhe dokumenti që vërteton lidhjen midis distributorit të autorizuar me firmën

prodhuese. (Autorizimi të jetë i përkthyer dhe noterizuar nëse nuk është në gjuhën shqipe). Çdo autorizim që do të paraqitet duhet të përmbajë të dhënat e plota të prodhuesit si: Tel, Fax, E-mail, Website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor në formulimin e kriterit mbi prodhimin ose origjinën e prodhimit të mallrave objekt prokurimi ka kërkuar autorizim ose kontratë furnizimi për këto mallra, me qëllim blerjen e artikujve origjinalë nga distributor të autorizuar për shitjen e tyre dhe jo atyre të kopjuar, ç'ka përbën dallim në vërtetësinë dhe cilësinë e çdo produkti.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____
(Emri, Mbiemri, Firma)

2. _____
(Emri, Mbiemri, Firma)

3. _____
(Emri, Mbiemri, Firma)